



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 265 Prot.

Tiranë, më 07.09/2015

Lënda: Dërgohet Vendimi nr.127, datë 07.09.2015, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Drejtar: - DREJTORISË RAJONALE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

GJIROKASTËR

- Z. ~~Ministri i Drejtimit~~
Lagjia "Mustafa Matohiti"

TEPELENË

Bashkëlidhur ju dërgojmë Vendimin nr.127, datë 07.09.2015, e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi ankesën nr. 40, datë 04.05.2015, e Z. ~~Ministri i Drejtimit~~

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Irma BARAKU

KOMISIONERI



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 127, Datë 07.09.2015

Pasi u njoh me ankesën nr. 40, datë 04.05.2015 të shtetasit Mehmet Zhupa, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërmë a), të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 40, datë 04.05.2015 të shtetasit ~~Mehmet Zhupa~~, ku pretendohet për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore dhe gjendjes shëndetësore, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, ankuesi është punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër në muajin qershori 1996 dhe në muajin prill 2014 është liruar nga detyra me motivacionin¹ “*mospërputhje e arsimit me vendin e punës*”. Pozicioni i punës së Z. [redacted] ka qenë Inspektor i Sigurimit vullnetar. Ai shprehet se në muajin dhjetor 2013 i është dërguar njoftimi për ndërprerje të marrëdhënieve të punës me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, ndërkohë që nuk i është dhënë asnjëherë Urdhëri i Lirimit nga detyra. Për sa më sipër, ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes së tij arsimore, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër. Ndër të tjera, ankuesi shprehet se është larguar nga puna, ndërkohë që ka qenë me raport mjekësor. Një fakt i tillë është konstatuar edhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, nëpërmjet vendimit nr. 678, datë 04.11.2014.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë :

¹ Referuar shënimëve në librezën e punës së ankuesit.

- Pas analizimit të ankesës nr. 40, datë 04.05.2015 të shtetasit Mehmet Zhupa, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsy, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- Mbështetur në nenin² 33, pika 7, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 413/1, datë 06.05.2015, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e ankuesit *Mehmet Zhupa*. Në këtë kontekst, KMD kërkoi nga DRSSH Gjirokastër edhe dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Urdhëri i lirimt nga detyra të Z. *Zhupa*
 - Numri i punonjësve të larguar nga puna me të njëjtin motivacion me ankuesin;
 - Përshkrimi i punës për pozicionin e punës “Inspektor i Sigurimeve Vullnetare”;
 - Kopje e strukturës organike aktuale të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër;
 - CV e ankuesit, si dhe një kopje e diplomës së tij (Shkollës së Mesme Ekonomike).
 - Informacion mbi gjendjen arsimore të personit, që është punëuar në ish-pozicionin e punës së Z. *Zhupa*.

- Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër dërgoi shkresën nr. 1803/1, datë 13.05.2015, ku jepen sqarimet përkatëse mbi çështjet e ngritura nga Z. *Zhupa*.

Referuar shkresës nr.1803/1, datë 13.05.2015, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, Z. *Zhupa*, a është larguar nga ky institucion me motivacionin “mospërputhje e arsimit me vendin e punës”. Z. *Zhupa* ka arsim të mesëm ekonomik, ndërkohë që në bazë të strukturës organizative të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, në pozicionin e punës “specialist i sigurimit vullnetar” kërkohej arsimi i lartë. Me këtë motivacion, janë larguar nga puna 11 punonjës nga DRSSH Gjirokastër. Në vend të Z. *Zhupa* është punëuar Znj. *Emri i zbuluar*, e cila ka arsimin e lartë në degën Ekonomi. Bashkëlidhur shkresës në fjalë, DRSSH Gjirokastër ka dërguar të gjithë dokumentacionin përkatës, të kërkuar nga Komisioneri.

- Në vijim të procedurave hetimore, referuar Urdhërit nr. 97, datë 11.06.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit pranë Drejtorisë rajonale të Sigurimeve Shoqërore, me qëllim kryerjen e verifikimeve, mbi ankesën e Z. *Mehmet Zhupa*”, ekipi i inspektimit të KMD-së, në datën 24.06.2015, kreu inspektim pranë kësaj Shoqërie.

²Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon :“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Objekti i inspektimit konsistonte në çështjet e mëposhtëme :

- Kryerja e verifikimeve mbi arsyet e lirimit nga detyra të Z. ~~zgjedha~~, me detyrë Kryetar
- Kryerja e verifikimeve mbi procedurat e lirimit nga detyra të Z. ~~zgjedha~~, me detyrë Kryetar
- Kryerja e verifikimeve mbi lirimin nga detyra të punonjësve të tjerë të DRSSH Gjirokastër, me motivacionin “*mospërputhje e arsimit me vendin e punës*”.
- Mbledhja dhe administrimi i informacioneve të tjera, që kanë lidhje me ankesën e Z. ~~zgjedha~~

Gjatë inspektimit, grupi i inspektorëve të KMD-së u takua me Z. ~~zgjedha~~, me detyrë Kryetar i Degës së Administrimit, të DRSSH Gjirokastër, i cili dha sqarimet përkatëse lidhur me çështjet që përbën objektin e inspektimit. Sipas tij, Z. ~~zgjedha~~ është larguar nga detyra si rrjedhojë e mospërputhjes së arsimit me vendin e punës, sepse në bazë të strukturës së institucionit, në pozicionin e punës së ankuesit kërkohej si kriter arsimi i lartë. Menjëherë pas emërimit në detyrë të drejtorit të ri të DRSSH Gjirokastër, në muajin nëntor 2013, u morën të gjitha masat e nevoishme për zbatimin e struktureve përkatëse të këtij institucioni. I pyetur në lidhje me Z. ~~zgjedha~~ i cili në bazë të strukturës së dërguar nëpërmjet shkresës nr.1803/1, datë 13.05.2015, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, rezultonte të kishte arsim të mesëm dhe aktualisht është ende në pozicionin e tij të punës si specialist i fondit të kontributeve, Z. Gjokoli sqaroi se Z. ~~zgjedha~~ kishte qënë në proces diplomimi dhe aktualisht është i diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë, pranë Universitetit Kristal. Z. ~~zgjedha~~ heksoi faktin se Z. ~~zgjedha~~ kishte paraqitur rregullisht pranë institucionit, vërtetime të lëshuara nga Universiteti “Kristal”, ku vërtetohej se ai ishte duke ndjekur studimet e larta. Kryetari i Degës së Administrimit, të DRSSH Gjirokastër i sqaroi inspektorët e KMD-së, se me të njëjtin motivacion me Z. ~~zgjedha~~ ishin larguar edhe 11 punonjës të tjerë të këtij institucioni, të cilët ishin me arsim të mesëm, në vend të arsimit të lartë, që kërkohej si kriter nga struktura e DRSSH Gjirokastër. Për sa i përket procedurës së ndjekur përlargimin nga puna të Z. ~~zgjedha~~, Z. ~~zgjedha~~ sqaroi se në bazë të shkresës nr. 2518/8, datë 13.12.2013, ankuesi është njoftuar përfillimin e procedurës përzgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës. Më pas nëpërmjet shkresës nr. 738/1, datë 13.03.2014 drejtuar Degës së Financës, Z. ~~zgjedha~~ i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. I pyetur nëse ekzistonte ndonjë urdhër apo vendim nëpërmjet të cilit ishin zgjidhur përfundimisht marrëdhëniet e punës së ankuesit me DRSSH Gjirokastër, Z. ~~zgjedha~~ sqaroi se në njoftim përcaktohej saktë data kur do të ndërpriteshin marrëdhëniet e punës.

Ndër të tjera, Z. ~~zgjedha~~ i informoi inspektorët e Komisionerit se në dosjen personale të Z. ~~zgjedha~~, që administrohej nga DRSSH Gjirokastër nuk ndodhej asnjë diplomë apo listë notash të shkollës së mesme ekonomike. Në këtë dosje administrohen vetëm disa karakteristika, si dhe një vërtetim i Shkollës së Bashkuar “Sali Nivica”, datë 11.11.1989, ku vërtetohet se arsimi i marrë prej tij është “teknikum minierash”. Sikurse u verifikua edhe nga inspektorët e Komisionerit në këtë dosje nuk rezultonte asnjë kopje diplome dhe listë notash të Shkollës së Mesme Ekonomike Tiranë, sikurse rezultonte të ishte shkruar në librezën e tij të punës.

Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, rezultoi se:

- I- Referuar strukturës organizative të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër për vitin 2009, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për pozicionin “specialist i sigurimit vullnetar” është përcaktuar si kriter “arsimi i lartë”. Në këtë pozicion pune ka qënë punësuar Z. Muhamed Zhubri, i cili referuar shënimëve në librezën e tij të punës dhe karakteristikave të administruara në dosjen e tij personale të punës, ka kryer arsimin e mesëm, dega ekonomi agrare.

Sipas akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, me motivacionin “mospërputhje e arsimit me vendin e punës”, u është zgjidhur kontrata e punës 11 punonjësve të DRSSH Gjirokastër, përkatësisht:

1. ~~Z. Muhamed Zhubri~~;
2. ~~Sh. Shabani~~,
3. ~~Mehmet Zhupri~~;
4. ~~Sh. Ll. Imeri~~;
5. ~~Sh. S. Krasniqi~~;
6. ~~Sh. A. Zemani~~;
7. ~~Sh. A. Gjergjaj~~;
8. ~~Kemal Dafa~~;
9. ~~Sh. E. Blloshi~~;
10. ~~Klementi Lipa~~;
11. ~~Sh. Hoxha~~.

Nëpërmjet shkresës nr. 1803/1, datë 13.05.2015, të DRSSH Gjirokastër, si dhe përgjatë procesit të hetimit, rezultoi se struktura e mësipërme, lidhur me kriterin e arsimit të lartë nuk ishte zbatuar për Z. ~~Jalil Ibrahim~~, i cili në periudhën kohore, kur janë kryer largimet nga puna, ishte ende me arsim të mesëm, ndërkohë që edhe për pozicionin e tij të punës si specialist i fondit të kontributive ishte përcaktuar si kriter “arsimi i lartë”. Referuar diplomës së tij, të lëshuar nga Universiteti “Kristal” rezulton se ai është diplomuar në datën 10.07.2014.

Gjithashtu, në çështjen administrative me paditës – ~~Mehmet Zhubri~~, palë të paditur – Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër dhe me objekt gjykimi – detyrim pagim dëmshpërbllimi për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara nga punëdhënësi etj., Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, referuar vendimit³ të saj nr. 339, datë 26.05.2014, është shprehur: “*Pretendimi i anës së paditur të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës për shkak të mospërputhjes së vendit të punës me kualifikimin e paditësit nuk përbën shkak të ligjshëm dhe të bazuar në prova. Paditësi për më shumë se 20 vjet ka punuar pranë anës së paditur dhe pas kësaj periudhe kohe pretendohet për mospërputhje të vendit të punës me kualifikimin e paditësit. Paditësi me të njëjtin kualifikim ka kryer detyrimet*

³ Faqja 5 e Vendimit nr. 339, datë 26.05.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.

kontraktore për rreth njëzet vjet dhe se gjatë kësaj periudhe nuk është ndërshtuar asnjëherë me masë disiplinore, në asnjë rast nuk ka shkelur detyrimet kontraktore”.

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose private, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupei personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpermendura, gjykojmë se Z. Zhupa, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga ana e DRSSH Gjirokastër, në krahasim me Z. Ky trajtim, ka lidhje të drejtpërdrejtë, me gjendjen e tij arsimore.

II – Në bazë të hetimit administrativ rezulton se Z. Zhupa ka filluar punë pranë DRSSH Gjirokastër në datën 01.07.1993 dhe referuar librezës së punës, atij i janë ndërprerë marrëdhëni et e punës në datën **01.04.2014. Referuar Raportit për Paaftësi të Përkoħshme në punë Nr. 2106 Regjistri, datë 31.03.2014, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Tepelenë, ankuesit i është dhënë pushim për 14 ditë, pushim i cili fillonte në datën **01.04.2014** dhe përfundonte në datën **15.04.2014**. Raporti i mësipërm është ndjekur edhe nga disa raporte të tjera, deri në datën 16.07.2014.**

Në çështjen administrative me paditës – Z. Zhupa, palë të paditur – Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër dhe me objekt gjykimi – detyrim pagimi i raportit për paaftësi të pérkoħshme në punë për sémundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi etj., Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, referuar vendimit të saj nr. 678, datë 04.11.2014, është shprehur për pranimin e kérkesëpadisë dhe detyrimin e DRSSH Gjirokastër t'i paguajë paditësit Mehmet Zhupa, të ardhurat për sémundjen, të vërtetuara me raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes dhe Komisioni Mjekësor, nga data 01.04.2014 e në vazhdim.

Për sa më sipër, rezulton se Z. Zhupa është liruar nga detyra, ndërkohë që ka qenë me raport mjekësor, gjë që bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 147, pika 1 të Kodit të Punës, ku parashikohet shprehimi si :

“1. Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontraten në kohën kur, sipas legislacionit në fuqi, punëmarrësi kryen shërbimin ushtarak, përfiton pagesë paaftësie të pérkoħshme në punë nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore, për një periudhe deri në një vit, si dhe kur punëmarrësi është me pushime te dhëna nga punëdhënësi”.

Në këto kushte, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Z. Zhupa është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë me persona të tjerë në kusnë të njëjta apo të ngashme nga ana e DRSSH Gjirokastër, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.

Në këtë kontekst Komisioneri, në bazë të fakteve dhe provave të mësipërme, vlerëson se Z. Zhupa është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore.

Në bazë të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka tagër për dhënie dëmshpërbëlimi moral (financiar), ndaj ankuesi duhet t’i drejtohet gjykatës, për të përfituar këtë dëmshpërbëlim.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 2 3, pika 1, 4, pika 1, 7, pika 1, nenet 12, 13, 14 e 15, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërmë a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 e 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe nenit 147, pika 1 të Kodit të Punës,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjendjes arsimore dhe gjendjes shëndetësore të Z. Zhupa, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, për rikthimin në punë të Z. Zhupa
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra përzbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij nenit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Irma BARAKU

